DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

A-488727

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vrasja e modeles 28-vjeçare, dalin detaje të rënda/ Kishin siguruar edhe një makinë grirëse mishi
ADRESA	`https://piranjat.al/bota/vrasja-e-modeles-28-vjecare-dalin-detaje-te-renda-kishin-siguruar-edhe-nje--i107272`
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	2 tetor 2026, 16:53:02 UTC *Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.*
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 tetor 2026, 16:44:00 UTC *Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.*

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	`8a8bb38ede48681715c06abc9ec8fbfa8e74bc833516090467cbe1ddf1ef3540`
TEKSTI	`f6bffaf0b8295997b08ad4c2d67ad9256590f2342ee2c42560b10be8cb0ed0c8`
PAMJA	`8cb28138a167c02e52a55ae22fc1657bd17ebbeb54a0afee9ed369459a4ebe89`

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	`54ebd1b528a509127d3d7fe1c4cab79becf8322979a938abdab48935c0217d7f`
E MËPARSHMJA	–
RRËNJA MERKLE	–
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende *Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.*

SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/54ebd1b528a509127d3d7fe1c4cab79becf8322979a938abdab48935c0217d7f`

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Vrasja e modeles 28-vjeçare, dalin detaje të rënda/ Kishin siguruar edhe një makinë grirëse mishi

Piranjat Përditësimi i fundit 2 Tetor 2026, 18:44

Gjyqi për vrasjen e modeles dhe influencueses Abby Choi ka rikthyer në vëmendje një prej çështjeve kriminale më të bujshme të Hong Kongut. Më shumë se tre vite pas vdekjes së 28-vjeçares, Prokuroria ka paraqitur para gjykatës versionin e saj mbi mënyrën se si dyshohet se u organizua dhe u realizua krimi.

Sipas akuzës, vrasja nuk ishte një veprim i momentit. Prokurorët pretendojnë se disa anëtarë të familjes së ish-bashkëshortit të Choi kishin nisur përgatitjet disa ditë përpara ngjarjes.

Të tre përballen me akuzën e vrasjes, por janë deklaruar të pafajshëm.

Prokuroria pretendon se përgatitjet për krimin përfshinin marrjen me qira të një banese në zonën e Tai Po. Sipas akuzës, në këtë pronë ishin dërguar paraprakisht edhe pajisje të ndryshme që dyshohet se ishin siguruar për të fshehur gjurmët pas vrasjes.

Mes sendeve të përmendura nga prokurorët është edhe një makinë për grirjen e mishit. Hetuesit e vendosin momentin kryesor të ngjarjes më 21 shkurt 2023. Sipas versionit të paraqitur në gjykatë, Abby Choi u bind të hipte në një automjet pasi iu tha se do të shkonte për të marrë vajzën e saj nga shkolla.

Por Prokuroria pretendon se gjatë udhëtimit situata mori një tjetër rrjedhë. Sipas dëshmive dhe materialeve të paraqitura gjatë procesit, 28-vjeçarja dyshohet se u godit në kokë me një çekiç.

Më pas, sipas akuzës, ajo u dërgua në banesën e marrë me qira në Tai Po. Pikërisht aty prokurorët pretendojnë se trupi i saj u copëtua dhe se u përdorën mjete të ndryshme në përpjekje për të eliminuar provat e krimit.

Një tjetër element kyç i procesit është motivi.

Sipas Prokurorisë, pas vrasjes mund të ketë qëndruar një konflikt i fortë financiar mes Abby Choi dhe familjes së ish-bashkëshortit.

Në qendër të mosmarrëveshjes ishte një pronë luksoze, vlera e së cilës raportohet të ketë qenë rreth 60 milionë dollarë të Hong Kongut, ekuivalente me afërsisht 7.6 milionë dollarë amerikanë. Prokurorët po përpiqen të provojnë para gjykatës se pikërisht mosmarrëveshja për pronën dhe interesat financiare që lidheshin me të çuan në planifikimin e vrasjes.

Rasti i Abby Choi shkaktoi jehonë të madhe ndërkombëtare kur u bë publik në shkurt të vitit 2023, jo vetëm për shkak të profilit të saj si modele dhe influencuese, por edhe për rrethanat e rënda të krimit.

Tashmë, më shumë se tre vite pas ngjarjes, beteja kryesore po zhvillohet në sallën e gjyqit. Prokuroria po paraqet provat me të cilat synon të mbështesë versionin e një vrasjeje të planifikuar, ndërsa Alex Kwong, Kau Kwong dhe Anthony Kwong kanë mohuar akuzën për vrasje.

Procesi gjyqësor vijon dhe përgjegjësia penale e të akuzuarve mbetet për t'u përcaktuar nga gjykata.

Artikuj te sugjeruar

BOTA 2 Tetor18:25

Trump rrezikon kontrollin e Kongresit, ja 7 shtetet ku luhet beteja

Donald Trump nuk është në fletën e votimit më 3 nëntor, por zgjedhjet e mesmandatit do të përcaktojnë pjesën t...

BOTA 2 Tetor18:07

Darkë, pritje VIP dhe orë ari/ Shpërblimet për zotëruesit më të mëdhenj të $TRUMP

Kompania që qëndron pas monedhës meme $TRUMP të presidentit amerikan Donald Trump do të ftojë 185 zotëruesit më të ...

BOTA 2 Tetor18:07

Prisnin të vdiste, ajo filloi të qeshte! Minutat dramatikë të gruas së dënuar me vdekje gjatë procesit të ekzekutimit të dështuar

Krista Pike qeshi dhe këndoi gjatë përpjekjes për ekzekutimin e saj në Tenesi, ndërsa procesi u shndërrua në kaos pasi p...

BOTA 2 Tetor18:02

E pazakontë në Zvicër! Pasagjeri tentoi të kalonte mbi 1 kg kokainë në aeroport, i kishte fshehur në ëmbëlsira për fëmijë

Një rast i pazakontë kontrabande droge është zbuluar në Aeroportin e Cyrihut, në Zvicër, ku autoritetet gjetën më s...

BOTA 2 Tetor16:17

Rriten tensionet me Iranin, SHBA-të dërgojnë aeroplanmbajtësen e tretë drejt Gjirit Persik

Një aeroplanmbajtëse e tretë amerikane është nisur drejt Gjirit Persik, e shoqëruar nga anije të tjera luftarake dhe trupa ma...

BOTA 2 Tetor16:09

Greqi, shkatërrohet skema e mashtrimit me kriptomonedha, 17 të arrestuar

Një organizatë kriminale që dyshohet se mashtronte investitorët përmes një skeme me kriptomonedha është shkatërruar...

BOTA 2 Tetor15:18

Zelensky: Putin urdhëroi braktisjen e rregullave të luftës

Presidenti rus, Vladimir Putin i ka urdhëruar udhëheqjes ushtarake të Rusisë të braktisë rregullat e luftës, duke shkaktuar...

BOTA 2 Tetor15:14

Presidenti i Zvicrës njofton dorëheqjen

Presidenti zviceran Guy Parmelin njoftoi të premten se do të largohet nga qeveria në fund të vitit, në një veprim të paprit...

BOTA 2 Tetor15:11

Kapiteni i Flydubai rrëfen sulmin në kabinë: Avioni po binte, duhej të hapja derën

Kapiteni indian i një fluturimi të Flydubai, Smit Machchhar, ka rrëfyer nga spitali momentet e vështira gjatë incidentit në bord...

BOTA 2 Tetor14:16

Australia: Lojërat online si Steam dhe Roblox kanë boshllëqe të konsiderueshme për sigurinë e fëmijëve

Rregullatori i sigurisë online i Australisë ka gjetur boshllëqe të konsiderueshme në mënyrën se si platformat e njohura t&e...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 2 Tetor

Videot intime me Adi Hilën, Eli Fara dëshmon në...

Eli Fara ka dëshmuar në polici në lidhje me skandalin e videove intime të publikuara nga studioja e producentit Adrian Hila. Gjatë d...

SHOWBIZ 1 Tetor

“Më kontaktoi sot”/ Gazetari Elton Tozaj zbulon...

Elton Tozaj ka bërë një tjetër deklaratë lidhur me videot intime që kanë qarkulluar ditët e fundit në rrjet, duke z...

SHOWBIZ 2 Tetor

Monika Lubonja në qendër të vëmendjes për video...

Rrjetet sociale po “ziejnë” ditët e fundit pas publikimit të disa videove intime, ku në to shfaqen persona të njohur nga ...

Piranjat News INVESTIGIME 29 Shtator11:57

“2200 euro për person, kesh çdo ditë”/ Zbulohet skema si grupet kriminale rekrutojnë shoferët për transportin e emigrantëve ilegalë

Një rrjet i organizuar që vepron përtej kufijve dhe që dyshohet se përfiton shuma të konsiderueshme nga trafikimi i emigrant&eum...

video

PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2

PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2

Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.